



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

DREJTORIA E KOORDINIMIT TË SKS, PËRAFRIMIT DHE PROJEKTEVE
Sektori i Koordinimit dhe Planifikimit Strategjik

Raporti 4-mujor i monitorimit të Programit të Statistikave Zyrtare¹ (Shtator-Dhjetor, 2024)

¹ Ky raport hartohet në zbatim të Nenit 17, pika 5 të Ligjit nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”. Në mbështetje në nenit 17, pika 5 e Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT ka përgjegjësinë për t’i paraqitur Këshillit të Statistikave raporte të shkurtra 4-mujore për ecurinë e zbatimit të Programit të Statistikave Zyrtare.

INSTAT - Instituti i Statistikave

Tel+(355) 4 2222411
+(355) 4 2233356
Fax+(355) 4 2228300

Rr. Vllazën Huta, Nd. 35, H. 1, Nj.A. Nr.2, 1017,
Tiranë, Shqipëri

info@instat.gov.al



Tabela e Përmbajtjes

Hyrje	3
Treguesit e performancës së SKS në zbatim të objektivave zhvillimorë 2022-2026.....	4
Zbatimi i PSZ për periudhën Shtator- Dhjetor, 2024.....	6
Fusha statistikore 1: Statistikat Demografike dhe Sociale	7
Fusha statistikore 2: Statistikat Ekonomike	13
Fusha statistikore 3: Statistikat Sektoriale	19
Fusha statistikore 4: Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain	29
Menaxhimi i Cilësisë	32
Analiza e risqeve.....	32
Regjistrat e biznesit.....	Error! Bookmark not defined.

Hyrje

Programi i Statistikave Zyrtare është dokumenti bazë që parashikon prodhimin e statistikave zyrtare nga Sistemi Kombëtar Statistikor të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë. Monitorimi i ecurisë së programit është element shumë i rëndësishëm për garantimin e plotësimit të aktiviteteve statistikore të parashikuara në të.

Ligji nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” parashikon si një ndër instrumentet monitoruese raportimin periodik me bazë 4-mujore.

Raporti 4 - mujor mbi zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare (PSZ) për periudhën Shtator-Dhjetor, 2024, është përgatitur në bashkëpunim me agjencitë e tjera statistikore, të cilat kanë dhënë informacion për modulet statistikore nën përgjegjësinë e tyre sipas programit. Ky raport i referohet zbatimit të Planit Vjetor të PSZ për vitin 2024, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me vendim nr. 15/2024, datë 08.02.2024 “Për miratimin e Planit Vjetor 2024 për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026”. Raporti përmban në strukturën e tij një informacion të shkurtër mbi ecurinë 4 - mujore të treguesve strategjikë si matës afatshkurtër të ecurisë së Sistemit Kombëtar Statistikor në drejtim të zbatimit të objektivave strategjikë 2022-2026, një informacion të detajuar të ecurisë së aktiviteteve statistikore të planifikuara për secilën fushë për 4-mujorin referencë, si dhe informacion mbi treguesit kryesorë të cilësisë statistikore për këtë periudhë. Ecuria e aktiviteteve statistikore monitorohet nëpërmjet raportimit të zbatimit të afateve të fazave kryesore të prodhimit statistikor: grumbullimi, përpunimi, publikimi i të dhënave, si dhe transmetimi i tyre në Eurostat. Gjithashtu, për çdo aktivitet përcaktohet niveli i detajimit të të dhënave sa i përket disagregimit (mikro, makro) si dhe niveli gjeografik i tyre. Gjithashtu, për çdo aktivitet jepet dhe niveli i përputhshmërisë me standardet e Eurostatit, raportim i cili bazohet në vlerësimin e fundit sipas SMIS+. Për çdo fushë statistikore raportohen edhe aktivitetet statistikore për të cilat të dhënat nuk janë grumbulluar, përpunuar apo publikuar në kohë, shoqëruar me arsyen e moszbatimit të afateve. Pjesë e raportimit janë aktivitetet statistikore nga të cilat nuk prodhohen të dhëna statistikore, si aktivitetet e GIS dhe aktivitetet që lidhen me menaxhimin e cilësisë. Në këtë raport, në seksionin e fundit të dokumentit, paraqiten edhe aktivitetet kryesore të organizuara nga INSTAT gjatë periudhës raportuese.

Raportet 4 - mujore për zbatimin e PSZ janë dokumentet bazë të cilat paraqiten nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT për Këshillin e Statistikave dhe shërbejnë për hartimin e Raportit Vjetor, i cili i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë.

Progres-Raporti Shtator-Dhjetor, 2024

Gjatë periudhës Shtator-Dhjetor, 2024, agjencitë statistikore si: INSTAT, Banka e Shqipërisë Ministria e Financave, dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore janë angazhuar për realizimin e aktiviteteve statistikore që kanë nën përgjegjësi sipas Planit Vjetor 2024 për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022 – 2026.

Treguesit e performancës së SKS në zbatim të objektivave zhvillimorë 2022-2026

Duke qenë se në Programin e Statistikave Zyrtare 2022-2026 janë përfshirë objektivat zhvillimorë strategjikë, Sistemit Kombëtar Statistikor i lind detyrimi i raportimit në nivel 4 mujor mbi aktivitetet e kryera në drejtim të këtyre objektivave, performanca e të cilëve matet nëpërmjet treguesve respektivë.

Më poshtë paraqitet tabela me vlerat e treguesve për periudhën Shtator-Dhjetor, 2024, në një qasje krahasimore me vlerat e pritshme për vitin 2024.

Ecuria 4 mujore e treguesve strategjikë Shtator-Dhjetor, 2024

Objektivi	Treguesi	Vlera për periudhën Shtator-Dhjetor, 2024	Target line 2024
Objektivi strategjik 1: Zhvillimi i SKS për të përmbushur plotësisht acquis communautaire lidhur me statistikat dhe të mbështesë plotësisht procesin e integritimit Evropian	1.2 Numri i akteve të reja ligjore të përafruara me acquis (Sipas PKIE)	1	0
	1.3 Rekomandime të Eurostatit (nga raporti <i>Peer Review 2018</i>), të zbatuara (në %)	Realizuar në masën 100% gjatë vitit 2023	100%
Objektivi strategjik 2: Plotësimi i nivelit të plotë të kërkesave	2.2 Numri i vizitave në faqen e internetit të INSTAT-it	- ²	+10% nga viti i kaluar (në 2023 nr. i klikimeve ishte: 3.020.981)

² Vlera e këtij indikatori nuk mund të gjenerohet për periudhën reference për shkak të ndryshimit të platformës së google analytics: INSTAT po synon të kalojë në një platformë të ndryshme nga google analytics, në një platformë më të sigurt dhe do të migrojë të dhënat pasi të marrë licencën e kësaj platforme



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

të përdoruesit për statistika zyrtare	2.6 Numri i aktiviteteve statistikore të disagreguara në nivel minimal vendor	4	11
Objektivi strategjik 3: Prodhimi i statistikave zyrtare të një niveli të lartë cilësie, që të përputhen me standardet e pranura Evropiane dhe ndërkombëtare	3.2 Numri i raporteve të cilësisë të publikuara	28	43
Objektivi strategjik 4: Përfshirja e institucioneve shtesë prodhues në Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare	4.2 Numri i institucioneve furnizuese me të dhëna administrative mikro	2	4
	4.3 Numri i temave të trajnimeve të organizuara nga INSTAT	4	13
Objektivi strategjik 5: Modernizimi i mëtejshëm i proceseve, metodave, produkteve dhe shërbimeve statistikore për të përmirësuar cilësinë, dorëzimin në kohë dhe efikasitetin në kosto të statistikave zyrtare	5.3 Numri i aktiviteteve statistikore tek të cilat përdoren software	55	104
Objektivi strategjik 6: Rritja e besimit të publikut në SKS dhe njohja e tij si strukturë institucionesh me performancë të	6.2 Numri i referimeve ndaj produkteve të SKS-së në media, p.sh., në gazetat ditore kryesore ose në televizione	2474	3000

duhur dhe profesionalisht të pavarur			
--------------------------------------	--	--	--

Zbatimi i PSZ për periudhën Shtator-Dhjetor, 2024

Për periudhën Shtator-Dhjetor, 2024, janë parashikuar 55 aktivitete për publikimin e 84 produkteve statistikore - 74 produkte janë publikuar në kohë.

Ndarja e aktiviteteve dhe produkteve statistikore sipas agjencive statistikore rezulton të jetë:

INSTAT: përgjegjës për 44 aktivitete statistikore - planifikuar publikimi i 62 produkteve statistikore - realizuar në kohë publikimi për 53 produkte statistikore.

Banka e Shqipërisë: përgjegjës për 7 aktivitete statistikore - planifikuar publikimi i 17 produkteve statistikore - realizuar sipas planit.

Ministria e Financave: përgjegjës për 2 aktivitete statistikore - planifikuar publikimi i 3 produkteve statistikore - realizuar sipas planit.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore: përgjegjës për 2 aktivitete - Planifikuar publikimi i 2 produkteve statistikore - publikuar 1 produkt statistikor.

Rezultatet për 4-mujorin referencë, sipas fazave të prodhimit statistikor, janë si më poshtë:

- *Grumbullimi i të dhënave:*
 - Planifikuar grumbullimi i të dhënave për 87 produkte statistikore
 - Grumbulluar të dhënat në kohë për 85 produkte statistikore
 - 37 vrojtime: 32 PAPI; 5 CAPI;
 - 34 burime administrative: 7 mikro; 20 makro; 7 kombinuar (mikro+makro)
 - 5 burime të kombinuara: 1 mikro; 2 makro; 2 kombinuar (mikro+makro);
 - 9 burime të tipit “tjetër” (burime administrative+regjistra+databaza): 5 mikro; 4 kombinuar (mikro+makro)
 - Nuk janë grumbulluar të dhënat në kohë për 2 produkte statistikore.
- *Përpunimi i të dhënave:*
 - Planifikuar përpunimi i të dhënave për 103 produkte statistikore;
 - Përpunuar të dhënat në kohë për 100 produkte statistikore;
 - Nuk janë përpunuar të dhënat në kohë për 3 produkte statistikore.
- *Publikimi i të dhënave*
 - Planifikuar publikimi i 84 produkteve statistikore;
 - Realizuar në kohë publikimi i 74 produkteve statistikore;
 - Nuk është realizuar në kohë publikimi i 10 produkteve statistikore.

- Niveli minimal gjeografik i të dhënave të publikuara:

- Për 62 produkte statistikore të dhënat janë në nivel kombëtar;
- Për 4 produkte statistikore të dhënat janë në nivel rajoni;
- Për 7 produkte statistikore të dhënat janë në nivel qarku;
- Për 1 produkte statistikore të dhënat janë në nivel bashkie;

- *Transmetimi i të dhënave në Eurostat*

- Janë transmetuar të dhënat për 44 produkte statistikore

- *Niveli i përputhshmërisë me acquis i produkteve të publikuara:*

- 1 produkt plotësisht në përputhje
- 7 produkte me nivel të lartë përputhshmërie;
- 45 produkte me nivel të mesëm përputhshmërie;
- 9 produkte me nivel të ulët përputhshmërie;
- 12 produkte të pavlerësuara

Nga vlerësimi vjetor i Eurostat mbi numrin e data points për Shqipërinë rezulton se për vitin 2024 në databazën e Eurostat është përlogaritur në total numri prej 7,035,303 data points. Ndarja sipas fushave përkatëse është si më poshtë:

• Fusha 1: Statistikat demografike dhe Sociale	1,402,042	data points
• Fusha 2: Statistikat ekonomike	744,437	data points
• Fusha 3: Statistikat sektoriale	4,847,724	data points
• Fusha 4. Statistikat e mjedisit dhe multidomain (Multimodal data – 103 data points)	40,997	data points

Më poshtë paraqitet në mënyrë të detajuar ecuria e realizimit të aktiviteteve statistikore për secilën fushë statistikore sipas 4 fazave: grumbullim, përpunim, publikim, transmetim të dhënash.

Fusha statistikore 1: Statistikat Demografike dhe Sociale

Statistikat sociale përfshijnë një sërë fushash që lidhen me statistikën e popullsisë, tregut të punës dhe pagave, arsimit, shëndetësisë, të ardhurave dhe shpenzimeve të konsumit, mbrojtjes sociale, drejtësisë dhe krimit, kulturës, si dhe përdorimit të kohës.

- Objektivi kryesor i statistikave sociale është që të sigurojë të dhëna në kohë dhe me cilësi të lartë të treguesve statistikore, të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave sociale dhe ekonomike me qëllimin final të zhvillimit dhe përmirësimit të mirëqënies shoqërore, si dhe në monitorimin e impaktit të këtyre politikave në aspektet e ndryshme të jetës në vend.

Agjencia statistikore përgjegjëse: INSTAT

Për periudhën Shtator - Dhjetor 2024, në këtë fushë statistikore janë 6 aktivitete që kanë të planifikuar mbylljen e të paktën një prej fazave të prodhimit statistikor.

Gjatë kësaj periudhe është planifikuar realizimi publikimi i 13 produkteve statistikore, 5 prej të cilave janë publikuar në kohë.

*Numri i produkteve statistikore që janë listuar në fazat e mëposhtme (grumbullim / përpunim / publikim / transmetim) është i ndryshëm sepse 1 aktivitet statistikor mund të ketë në këtë periudhë mbyllje të 1,2,3 ose 4 fazave të prodhimit statistikor.

1. Grumbullimi i të dhënave:

- **Planifikuar grumbullimi i të dhënave për 9 produkte statistikore**
- **Grumbulluar të dhënat në kohë për prodhimin e 7 produkteve të mëposhtme statistikore:**

1. Statistika të tregut të punës, T3 - 2024
2. Statistika të forcave të punës, T3 - 2024
3. Statistikat mbi pagat, T3 - 2024
4. Statistika mbi ndihmën ekonomike, K2 - 2024
5. Statistika të aftësisë së kufizuar, K2 - 2024
6. Statistika të pagesës së papunësisë, T2 - 2024
7. Statistika të pagesës së papunësisë, T3 - 2024

- Për 1 produkt statistikore të dhënat janë grumbulluar me anë të vrojtimit, duke përdorur metodën PAPI.
- Për 6 produkte statistikore të dhënat janë marrë nga burime administrative dhe të dhënat janë të nivelit makro.


- **Nuk janë grumbulluar të dhënat në kohë për 2 produktet e mëposhtme:**
 - Statistika vitale, T3 - 2024

Arsyeja e moszbatimit të afatit: Mosdërgimi i të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

- Statistika të personave të dënuar dhe personave të pafajshëm, 2023

Arsyeja e moszbatimit të afatit: Mosdërgimi i të dhënave nga Ministria e Drejtësisë për shkak të reformimit të sistemit gjygjësor në Tiranë, arsye e cila ka vështirësuar procesin e grumbullimit të të dhënave nga Ministria e Drejtësisë.


Grafiku 1.1 Përmbledhja e fazës së grumbullimit për fushën: Statistikat Demografike dhe Sociale



2. Përpunimi i të dhënave

- **Planifikuar për tu përpunuar të dhënat për 11 produkte statistikore**
- **Përpunuar të dhënat në kohë për prodhimin e 8 produkteve statistikore të mëposhtme:**
 1. Statistika të tregut të punës, T3 - 2024
 2. Statistikat mbi pagat, T3 - 2024
 3. Statistika nga anketa e buxhetit të familjes, 2023
 4. Statistika nga anketa e të ardhurave dhe nivelit të jetesës, 2023
 5. Statistika mbi ndihmën ekonomike, K2 - 2024
 6. Statistika të aftësisë së kufizuar, K2 - 2024
 7. Statistika të pagesës së papunësisë, T2 - 2024
 8. Statistika të pagesës së papunësisë, T3 - 2024
- **Nuk janë përpunuar të dhënat në kohë për 3 produktet e mëposhtme:**
 - Statistika vitale, T3 - 2024
Arsyeja e moszbatimit të afatit: Mosdërgimi i të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.
 - Statistika të forcave të punës, T3 - 2024;
Arsyeja e moszbatimit të afatit: Shtyrë përpunimi për arsye metodologjike.
 - Statistika të personave të dënuar dhe personave të pafajshëm, 2023
Arsyeja e moszbatimit të afatit: Mosdërgimi i të dhënave nga Ministria e Drejtësisë solli shtyrjen e procesit të përpunimit të të dhënave.

Grafiku 1.2 Përmbledhja e fazës së përpunimit për fushën: Statistikat Demografike dhe Sociale



3. Publikimi i të dhënave

- **Planifikuar publikimi i të dhënave për 13 produkte statistikore**
- **Realizuar në kohë publikimi (njoftimi për shtyp, tabela e përditësuar, databaza e përditësuar) për 5 produktet statistikore të mëposhtme:**
 1. Të dhëna administrative të tregut të punës, T3 - 2024
 2. Pagat, T3 - 2024
 3. Anketa e strukturës së të ardhurave nga puna, 2022
 4. Anketa e buxhetit të njësive ekonomike familjare, 2023
 5. Anketa e të ardhurave dhe nivelit të jetesës në shqipëri, 2023
 - Për 4 produkte statistikore niveli minimal i të dhënave është niveli kombëtar
 - Për 1 produkt statistikore niveli minimal i të dhënave është qarku
- **Të dhënat nuk janë publikuar në kohë për 8 produktet e mëposhtme:**
 - Statistika vitale, T3 - 2024
Arsyeja e moszbatimit të afatit: Mosdërgimi i të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.
 - Statistika të forcave të punës, T3 - 2024;
Arsyeja e moszbatimit të afatit: Shtyrë publikimi për arsye metodologjike. Të dhënat do të publikohen në një afat të pacaktuar.
 - Statistika nga anketa e edukimit të të rriturve, 2023;
Arsyeja e moszbatimit të afatit: Shtyrë publikimi për arsye metodologjike.


- Statistika të ndihmës ekonomike, K2 - 2024; Statistika të aftësisë së kufizuar, K2 - 2024; Statistika të pagesës së papunësisë, T2 - 2024, Statistika të pagesës së papunësisë, T3 - 2024.

Arsyeja e moszbatimit të afatit: Për të mos cënuar cilësinë statistikore, statistikat e kësaj kategorie nuk janë publikuar në kohë për arsye të nevojës për *cross-check* dhe verifikimit të burimeve administrative, si dhe është duke u analizuar gjithashtu mundësia e rishikimit të formatit të publikimit.

- Statistika të personave të dënuar dhe personave të pafajshëm, 2023

Arsyeja e moszbatimit të afatit: Mosdërgimi i të dhënave nga Ministria e Drejtësisë ka shtyrë dhe procesin e publikimit të të dhënave.

Grafiku 1.3 Përmbledhja e fazës së publikimit për fushën: Statistikat Demografike dhe Sociale



4. Transmetimi


- Janë transmetuar në Eurostat të dhënat për 4 produktet e mëposhtme:

1. Statistikat e popullsisë
2. Statistikat vitale, 2023
3. Statistikat e fitimit dhe lënies së shtetësisë
4. Statistika të fitimeve dhe kostove të punës

- Niveli i përputhshmërisë me *acquis* për produktet e publikuara:

- 2 produkte me nivel të mesëm përputhshmërie
- 2 produkte me nivel të ulët përputhshmërie
- 1 produkt i pavlerësuar

1.4. Grafiku i nivelit të përputhshmërisë me acquis për fushën: Statistikat Demografike dhe Sociale



➤ Aktivitetet në kuadër të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023

Gjatë periudhës Shtator-Dhjetor, 2024, aktivitetet e kryera në kuadër të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023 janë si më poshtë:

Shtator 2024: Aktivitetet e tabulimit të rezultateve në nivel qarku, bashkie dhe njësie administrative të CENS 2023 u fokusuan në:

- Ndërtimin e infrastrukturës statistikore për automatizimin dhe gjenerimin e tabelave në nivel NjEF dhe individit, banese dhe ndërtese të detajuara sipas qarqeve dhe bashkive përkatëse;
- Ndërtimin e skemave për çdo qark (dhe bashki/njësi administrative përkatëse), me qëllim gjenerimin automatik të setit të tabelave të planifikuara;
- Vijimin e punës për prodhimin e tabelave dhe draftimin e publikimeve të dedikuara në nivel qarku;
- Menaxhimin e zbulimit statistikor.

Tetor 2024:

- Publikimi i 12 botimeve të dedikuara në nivel qarku/bashkie dhe njësie administrative;
- Përgatitja dhe ngarkimi i të dhënave të Censit të detajuara në nivel qarku/bashkie dhe njësie administrative në PX-Web;
- Organizimi i workshop-it për shpërndarjen e rezultateve përfundimtare të Censit në nivel rajonal.

Nëntor-Dhjetor 2024:

- Prodhimi i treguesve në nivele të ndryshme detajimi mbi popullsinë, NjEF, arsimin, shëndetësinë, etj, me qëllim pasurimin e gjeo-databazës;

- Integrimi i të dhënave të gjeo-databazës në Px-Web;
- Përgatitja e hartave për publikim në nivel rajonal dhe administrativ;
- Vijimi i punës për vlerësimin e projeksioneve të popullsisë.

Fusha statistikore 2: Statistikat Ekonomike

Statistikat ekonomike përfshijnë fushat si: statistikat makroekonomike, statistikat financiare të qeverisë, fiskale dhe sektorit publik dhe statistikat e biznesit, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në hartimin e politikave ekonomike dhe përbëjnë bazën kryesore të informacionit për analiza të mëtejshme mbi zhvillimin dhe ndryshimet strukturore të ekonomisë së vendit.

- Qëllimi kryesor i statistikave ekonomike është që të sigurojnë të dhëna në kohë dhe me cilësi të lartë të treguesve statistikore, të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave ekonomike si dhe në monitorimin dhe menaxhimin e këtyre fushave.

Agjencitë statistikore përgjegjëse: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave.

Për periudhën Shtator-Dhjetor, 2024, për këtë fushë statistikore janë planifikuar 13 aktivitete statistikore që kanë mbylljen e të paktën një prej fazave të prodhimit statistikor.

Gjatë kësaj periudhe është planifikuar të realizohet publikimi i 21 produkteve statistikore, 20 prej të cilave janë publikuar në kohë.

Aktivitetet dhe publikimet e planifikuara/realizuara sipas agjencive janë si më poshtë:

- INSTAT është përgjegjës për 9 aktivitete statistikore - planifikuar publikimi i 13 produkteve statistikore - publikuar në kohë 12 produkte statistikore.
- Banka e Shqipërisë është përgjegjës për 2 aktivitete statistikore - planifikuar publikimi i 5 produkteve statistikore - realizuar sipas planit.
- Ministria e Financave është përgjegjës për 2 aktivitete statistikore - planifikuar publikimi i 3 produkteve statistikore - realizuar sipas planit.

*Numri i produkteve statistikore që janë listuar në fazat e mëposhtme (grumbullim / përpunim / publikim / transmetim) është i ndryshëm sepse 1 aktivitet statistikor mund të ketë në këtë periudhë mbyllje të 1,2,3 ose 4 fazave të prodhimit statistikor.


1. Grumbullimi i të dhënave

- **Planifikuar grumbullimi i të dhënave për 16 produkte statistikore**
- **Grumbulluar të dhënat në kohë për prodhimin e 16 produkteve statistikore të mëposhtme:**
 1. Llogaritë jo-financiare sipas sektorëve institucional



2. Llogaritë kombëtare vjetore-Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) me metodën e Prodhimit dhe Shpenzimeve
3. Llogaritë kombëtare tremujore - produkti i brendshëm bruto (PBB) me metodën e prodhimit dhe shpenzimeve, T2 - 2024
4. Llogaritë kombëtare tremujore - produkti i brendshëm bruto (PBB) me metodën e prodhimit dhe shpenzimeve, T3 - 2024
5. Tabelat burim-përdorime
6. Statistikat monetare dhe financiare, M8 - 2024
7. Statistikat monetare dhe financiare, M9 - 2024
8. Statistikat monetare dhe financiare, M10 - 2024
9. Statistikat monetare dhe financiare, M11 - 2024
10. Statistikat e borxhit të sektorit buxhetor të qeverisë dhe borxhit të garantuar, T3 - 2024
11. Statistikat Financiare të Qeverisë sipas ESA2010
12. Statistikat e Procedures së Deficitit të Tejkalluar, për 6 mujorin e parë, 2024
13. Statistikat afatshkurtra të ndërmarrjeve, T3 - 2024
14. Statistikat e çmimeve në ndërmarrjet ekonomike në nivel tremujor, T3 - 2024
15. Statistika mbi lejet e ndërtimit të miratuara në territorin e Republikës së Shqipërisë, T3 - 2024
16. Anketa e Regjistrave të Biznesit (ARB)
 - Për 2 produkte statistikore të dhënat janë grumbulluar me anë të vërtetimit, ku për 1 produkt është përdorur metoda PAPI dhe për 1 produkt është përdorur metoda CAPI.
 - Për 6 produkte statistikore të dhënat janë marrë nga burimi administrative, ku për 2 produkte të dhënat janë mikro, për 2 produkte të dhënat janë makro, ndërsa për 2 produkte të tjera të dhënat janë të kombinuara (mikro+makro).
 - Për 4 produkte statistikore të dhënat janë marrë nga burime të kombinuara (Vërtetim+Burim administrativ), ku të dhënat për 1 produkt janë mikro, për 2 produkte të dhënat janë makro, ndërsa për 1 produkt tjetër të dhënat janë të kombinuara (Mikro+Makro).
 - Për 4 produkte burimi i të dhënave është i tipit “Tjetër”, ku të dhënat merren nga burime administrative, regjistra, databaza dhe janë të nivelit të kombinuar (mikro+makro).

Grafiku 2.1 Përmbledhja e fazës së grumbullimit për fushën: Statistikat Ekonomike




2. Përpunimi i të dhënave

- **Planifikuar përpunimi i të dhënave për 20 produkte statistikore**
- **Përpunuar të dhënat në kohë për prodhimin e 20 produkteve statistikore të mëposhtme:**
 1. Llogaritë jo-financiare sipas sektorëve institucional
 2. Llogaritë kombëtare vjetore-Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) me metodën e Prodhimit dhe Shpenzimeve
 3. Llogaritë kombëtare tremujore - produkti i brendshëm bruto (PBB) me metodën e prodhimit dhe shpenzimeve, T2 - 2024
 4. Llogaritë kombëtare tremujore - produkti i brendshëm bruto (PBB) me metodën e prodhimit dhe shpenzimeve, T3 - 2024
 5. Tabelat burim-përdorime dhe input-output
 6. Llogaritë Financiare sipas Sektorëve Institucionale
 7. Statistikat monetare dhe financiare, M8 - 2024
 8. Statistikat monetare dhe financiare, M9 - 2024
 9. Statistikat monetare dhe financiare, M10 - 2024
 10. Statistikat monetare dhe financiare, M11 - 2024
 11. Statistikat Financiare të Qeverisë sipas GFSM2014 dhe Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Qeverisë
 12. Statistikat e borxhit të sektorit buxhetor të qeverisë dhe borxhit të garantuar, për T3, 2024
 13. Statistikat Financiare të Qeverisë sipas ESA2010
 14. Statistikat e Procedurës së Deficitit të Tejkalluar, për 6 mujorin e parë, 2024
 15. Statistikat e produkteve industriale (PRODCOM)
 16. Statistikat afatshkurtra të ndërmarrjeve, T2 - 2024
 17. Statistikat afatshkurtra të ndërmarrjeve, T3 - 2024

- 18. Statistikat e çmimeve në ndërmarrjet ekonomike në nivel tremujor, T2 - 2024
- 19. Statistikat e çmimeve në ndërmarrjet ekonomike në nivel tremujor, T3 - 2024
- 20. Statistika mbi lejet e ndërtimit të miratuara në territorin e Republikës së Shqipërisë, T3 – 2024

Grafiku 2.2 Përmbledhja e fazës së përpunimit për fushën: Statistikat Ekonomike



3. Publikimi i të dhënave

- **Planifikuar për tu publikuar të dhënat për 21 produkte statistikore**
- **Realizuar në kohë publikimi (njoftimi për shtyp, tabela e përditësuar, databaza e përditësuar) për 20 produktet statistikore të mëposhtme:**
 - 1. Llogaritë jo-financiare sipas sektorëve institucionalë
 - 2. Produkti i brendshëm bruto, finale 2022
 - 3. Produkti i brendshëm bruto, gjysëmfinal 2023
 - 4. Produkti i brendshëm bruto, T2 - 2024
 - 5. Produkti i brendshëm bruto, T3 - 2024
 - 6. Tabelat Burim-Përdorime dhe Input - Output 2022
 - 7. Produkti i Brendshëm Bruto i revizionuar
 - 8. Statistikat e llogarive financiare sipas sektorëve institucionalë
 - 9. Statistikat monetare, M8 -2024
 - 10. Statistikat monetare, M9 - 2024
 - 11. Statistikat monetare, M10 - 2024
 - 12. Statistikat monetare, M11 - 2024
 - 13. Statistikat financiare të qeverisë sipas GFSM 2024
 - 14. Buletini i treguesve të borxhit, T2 - 2024
 - 15. Buletini i treguesve të borxhit, T3 - 2024
 - 16. Statistikat e produkteve industriale (PRODCOM), 2023


17. Statistikat Afatshkurtra, T2-2024: Shërbimet, Prodhuesit e të mirave; Tregtia me Pakicë
18. Statistikat Afatshkurtra, T3-2024: Shërbimet, Prodhuesit e të mirave; Tregtia me Pakicë
19. Indeksi i çmimeve të prodhimit, T3 - 2024; Indeksi i çmimeve të importit, T3 - 2024; Indeksi i kushtimit në ndërtim, T3 - 2024
20. Lejet e ndërtimit, T3 - 2024

* Indikatorë të rinj: gjatë kësaj periudhe është vlerësuar seti i plote i Llogarive të Sektorëve Institucional.

- Për 19 produkte statistikore niveli minimal i të dhënave është niveli kombëtar
- Për 1 produkt statistikor niveli minimal i të dhënave është bashkia

- **Të dhënat nuk janë publikuar në kohë për produktin e mëposhtëm:**
- PBB Rajonale 2022
- Arsyeja e moszbatimit të afatit: Shtyrë publikimi për arsye metodologjike.

Grafiku 2.3 Përmbledhja e fazës së publikimit për fushën: Statistikat Ekonomike



***Rishikimi Madhor i Llogarive Kombëtare 2024**

Më 27 Shtator 2024, Instituti i Statistikave (INSTAT), në përputhje me Kodin e Praktikave të Statistikave Evropiane dhe Politikën e Harmonizuar Evropiane për Rishikimin e Statistikave Makroekonomike, publikoi seritë e përditësuara kohore të Llogarive Kombëtare në kuadër të Rishikimit Madhor të treguesve të Llogarive Kombëtare, i cili sikurse ishte bërë i ditur publikisht, do të realizohej në Shtator 2024. Rishikimi i llogarive kombëtare konsistoi në:

- Përmirësime metodologjike në përputhje me standardet statistikore ndërkombëtare, të realizuara nën asistencën e Bashkimit Evropian, nëpërmjet projekteve IPA Shumë-përfutuese dhe Eurostat në fushën e Llogarive Kombëtare;
- Përmirësim të afateve kohore të përpunimit dhe publikimit të të dhënave si pasojë e burimeve të përmirësuara të të dhënave;
- Përmirësim të treguesve statistikorë me synim rritjen e gjithpërfshirjes në vlerësimet e Llogarive Kombëtare si pasojë e përmirësimit të metodave statistikore;
- Rritje të plotshmërisë së treguesve dhe tabelave të publikuara në faqen zyrtare dhe të transmetuara në Eurostat;
- Rritje të cilësisë, nivelit të krahasueshmërisë dhe përputhshmërisë së treguesve statistikorë.

Ky rishikim përfaqësoi një hap tjetër të rëndësishëm përpara në procesin e harmonizimit të statistikave zyrtare të Shqipërisë me rregulloret dhe standardet e BE-së në fushën e Llogarive Kombëtare dhe do të mbikëqyret dhe verifikohet nga Eurostat.

INSTAT vlerësoi për herë të parë treguesin e Prodhimit të Brëndshëm Bruto (PBB), me metodën e të ardhurave, si dhe publikimin e setit të plotë të Llogarive Kombëtare sipas Sektorëve Institucionalë. Mbështetur në standardet Evropiane të Llogarive (ESA 2010), përdorimi i tabelave Burim-Përdorime në vlerësimin e treguesve të llogarive kombëtare mundësoi jo vetëm integrimin e të gjitha burimeve të të dhënave në një sistem të vetëm, por siguroi vlerësimin përfundimtar të Prodhimit të Brëndshëm Bruto (PBB)-së me tre metodat e vlerësimit, me atë **të prodhimit, shpenzimeve dhe të ardhurave**, duke eliminuar mospërputhjet statistikore. Rishikimi madhor i llogarive kombëtare, krahas përmirësimeve në burime dhe metodologji, impaktoi dhe vlerësimet tremujore të PBB-së me metodën e prodhimit dhe të shpenzimeve duke ruajtur konsistencën me vlerësimet e këtij treguesi në terma vjetorë.

4. Transmetimi

➤ **Janë transmetuar në Eurostat të dhënat për 14 produktet e mëposhtme:**


1. Llogaritë jo-financiare sipas sektorëve institucional
2. Llogaritë kombëtare vjetore-Produkti i Brëndshëm Bruto (PBB) me metodën e Prodhimit dhe Shpenzimeve
3. Produkti i brëndshëm bruto, T2 - 2024
4. Produkti i brëndshëm bruto, T3 - 2024
5. Tabelat Burim-Përdorime dhe input-output, 2022
6. Llogaritë Financiare sipas Sektorëve Institucionalë
7. Statistikat Financiare të Qeverisë sipas ESA2010
8. Statistikat e Procedurës së Deficitit të Tejkalluar, 6 mujori i parë - 2024
9. Statistikat strukturore të ndërmarrjeve, paraprake 2023 (llogaritur me burim administrativ).
10. Statistikat e produkteve industriale (PRODCOM)
11. Statistikat Afatshkurtra, T2-2024: Shërbimet, Prodhuesit e të mirave; Tregtia me Pakicë

12. Statistikat Afatshkurtra, T3-2024: Shërbimet, Prodhuesit e të mirave; Tregtia me Pakicë
13. Indeksi i çmimeve të prodhimit, T3 - 2024; Indeksi i çmimeve të importit, T3 - 2024; Indeksi i kushtimit në ndërtim, T3 - 2024
14. Lejet e ndërtimit, T3 - 2024

➤ **Niveli i përputhshmërisë me acquis për produktet e publikuara është:**

- 5 produkte me nivel të lartë përputhshmërie
- 9 produkte me nivel të mesëm përputhshmërie
- 3 produkte me nivel të ulët përputhshmërie
- 3 produkte të pavlerësuar

Grafiku 2.4 Përmbledhja e fazës së transmetimit për fushën: Statistikat Ekonomike



Fusha statistikore 3: Statistikat Sektoriale

Statistikat sektoriale përfshijnë një sërë fushash heterogjene si: statistikat e bujqësisë, peshkimit dhe pyjeve, statistikat e energjisë, transportit, turizmit, statistikat mbi tregtinë e jashtme dhe bilancin e pagesave, statistikat e çmimeve, shkencës dhe teknologjisë, inovacionit.

- Objektivi kryesor i statistikave sektoriale është që të sigurojnë të dhëna në kohë me cilësi të lartë të treguesve statistikorë, të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave të përbashkëta mbi fushat e sipërpërmendura si dhe në monitorimin dhe menaxhimin e tyre.

Agjencitë statistikore përgjegjëse: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

Për periudhën Shtator-Dhjetor, 2024, për këtë fushë statistikore, janë planifikuar 31 aktivitete statistikore që kanë mbylljen e të paktën një prej fazave të prodhimit statistikor.

Gjatë kësaj periudhe është planifikuar realizimi i 46 publikimeve statistikore, 45 nga të cilat janë realizuar në kohë.

Aktivitetet dhe publikimet e planifikuara/realizuara sipas agjencive rezultojnë si më poshtë:

- INSTAT është përgjegjës për 24 aktivitete - planifikuar publikimi i 32 produkteve statistikore - realizuar sipas planit.
- Banka e Shqipërisë është përgjegjës për 5 aktivitete - planifikuar publikimi i 12 produkteve statistikore - realizuar sipas planit.
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore - përgjegjës për 2 aktivitete - Planifikuar publikimi i 2 produkteve statistikore - publikuar 1 produkt statistikor.

*Numri i produkteve statistikore që janë listuar në fazat e mëposhtme (grumbullim / përpunim / publikim / transmetim) është i ndryshëm sepse 1 aktivitet statistikor mund të ketë në këtë periudhë mbyllje të 1,2,3 ose 4 fazave të prodhimit statistikor.

1. Grumbullimi i të dhënave


- **Planifikuar grumbullimi i të dhënave për 62 produkte statistikore**
- **Grumbulluar të dhënat në kohë për prodhimin e 62 produkteve statistikore të mëposhtme:**
 1. Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve të gjeneruara nga vrojtimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve për gjedhë, derra dhe të imta, M8 - 2024
 2. Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve të gjeneruara nga vrojtimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve për gjedhë, derra dhe të imta, M9 - 2024
 3. Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve të gjeneruara nga vrojtimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve për gjedhë, derra dhe të imta, M10 - 2024
 4. Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve të gjeneruara nga vrojtimi mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve për gjedhë, derra dhe të imta, M11 - 2024
 5. Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve të gjeneruara nga vrojtimi mujor i aktivitetit të pularive për prodhimin e vezëve (konsum njerëzor), M8 - 2024
 6. Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve të gjeneruara nga vrojtimi mujor i aktivitetit të pularive për prodhimin e vezëve (konsum njerëzor), M9 - 2024
 7. Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve të gjeneruara nga vrojtimi mujor i aktivitetit të pularive për prodhimin e vezëve (konsum njerëzor), M10 - 2024
 8. Statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve të gjeneruara nga vrojtimi mujor i aktivitetit të pularive për prodhimin e vezëve (konsum njerëzor), M11 - 2024
 9. Statistikat e qumështit dhe nënprodukteve të tij të gjeneruara nga vrojtimi mujor në fabrikat që grumbullojnë dhe përpunojnë qumështin e lopës, M8 - 2024
 10. Statistikat e qumështit dhe nënprodukteve të tij të gjeneruara nga vrojtimi mujor në fabrikat që grumbullojnë dhe përpunojnë qumështin e lopës, M9 - 2024



11. Statistikat e qumështit dhe nënprodukteve të tij të gjeneruara nga vrojtimi mujor në fabrikat që grumbullojnë dhe përpunojnë qumështin e lopës, M10 - 2024
12. Statistikat e qumështit dhe nënprodukteve të tij të gjeneruara nga vrojtimi mujor në fabrikat që grumbullojnë dhe përpunojnë qumështin e lopës, M11 - 2024
13. Statistikat mbi llogaritë ekonomike në bujqësi
14. Statistikat mbi çmimet bujqësore, M8 - 2024
15. Statistikat mbi çmimet bujqësore, M9 - 2024
16. Statistikat mbi çmimet bujqësore, M10 - 2024
17. Statistikat mbi çmimet bujqësore, M11 - 2024
18. Statistikat e peshkimit dhe akuakulturës, T3 - 2024
19. Statistikat e energjisë, T3, 2024
20. Statistikat e bilancit të përgjithshëm energjitik
21. Statistikat e bilancit të energjisë elektrike, T3, 2024
22. Statistikat e bilancit të përgjithshëm të energjisë
23. Statistikat e transportit ajror, detar, ujqor i brendshëm dhe hekurudhor të mallrave dhe pasagjerëve, T3 - 2024
24. Statistikat e sigurisë në transport, M8 - 2024
25. Statistikat e sigurisë në transport, M9 - 2024
26. Statistikat e sigurisë në transport, M10 - 2024
27. Statistikat e sigurisë në transport, M11 - 2024
28. Statistikat e strukturave akomoduese, M8 - 2024
29. Statistikat e strukturave akomoduese, M9 - 2024
